



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Nr 374 prot.

Puke, 18 .02.2025

Procesverbal i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 18.02.2025 :
Duhet te ishin njoftuar per takimin e kryesise keshilltaret e meposhtem, por meqenese, ne zbatim nenit 52 , pika 1 germa a , Z. Dritan Asani dhe z. Alfons Gjergjaj kane pengese ligjore , pasi do te trajtohet edhe mocioni i paraqitur nga grupi I keshilltareve te Partise Social Demokrate nuk jane njoftuar per te marre pjese.

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjergjaj
6. Hazbi Terbuni

Jane njoftuar :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Besar Kuçi
4. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Besar Kuçi
4. Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Shkurt 2025

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 22.01.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2025.
3. Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"
4. Projekt-vendim " Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njësisive administrative , Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025"

5. Rishqyrtim i VKB nr. 55 datë 03.12.2024 " " Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"
6. Projekt-vendim " Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit"
7. Projekt-vendim : " Për një shtesë në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027"
8. Mocion mosbesimi nga grupi i këshilltarëve të Partisë Socialdemokrate për shkartinin e anetarit të këshillit të Qarkut Shkoder z. Dritan Asani për mosdhënie informacioni për zhvillimin e mbledhjeve të keshillit te Qarkut.
9. Të tjera.

Ne perfundim te mbledhjes kryesia , pas diskutimit te anetareve vendosi te miratoje te gjitha pikat e projekt-rendit te dites, me perjashtim te pikes 8 , qe kishte disa paqartesi, te cilat po i paraqesim me poshte:

Mocioni i mosbesimit me nr. 125 date 22.01.2025 eshte i firmosur vetem nga Alfons Gjergjaj dhe ka ne liste edhe 4 persona te tjere(Eduard Gjoka, Aida Cenaj, Leze Kolaj dhe Ndue Lalaj),

Ndersa Mocioni i mosbesimit me nr. 125/1 date 22.01.2025 ka te njejten permbajtje eshte i firmosur nga 4 persona , njera prej te cileve , Leze Kolaj nuk kishte marre akoma mandatin nga keshilli(ne momentin e firmosjes se mocionit) , Aida Cenaj nuk ka firmosur dhe lista nuk eshte e njejte me listen ne mocionin e pare. Nisur nga kjo pika 8 nuk u perfshi ne rendin e dites.

Kryesia mori Vendimin nr.1 date 18 .02.2025, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar. Po keshtu u percaktua dhe data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit, sipas shenimit ne njoftimin e mbledhjes.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 22.01.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2025.

3. Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"
4. Projekt-vendim " Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njësisive administrative , Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025"
5. Rishqyrtim i VKB nr. 55 datë 03.12.2024 " " Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"
6. Projekt-vendim " Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit"
7. Projekt-vendim : " Për një shtesë në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027"
8. Të tjera.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përhershme të këshillit zhvillohen më datë 25.02.2025 , nga ora 13-⁰⁰ deri ne oren 16 ⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

- | | |
|--------------------|----------------------|
| 1. Gjon Gjoka | Kryetari I keshillit |
| 2. Enver Sulejmani | zv/ kryetar |
| 3. Besar Kuçi | Anetar |
| 4. Hazbi Terbuni | Sekretar I keshillit |

